

VENDIM
Nr. 45, datë 10.11.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 245, DATË 2.6.2022, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME VLORË”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 10.11.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 245, datë 2.6.2022, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë’”

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë (UK Vlorë) me shkresën nr. 2336 prot., datë 6.10.2023, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vlorë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Vlorë me vendimin nr. 245, datë 2.6.2022, “Për licencimin e sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i shoqërisë UK Vlorë sh.a., znj. Raimonda Alliaj ka përfunduar Fakultetin e Ekonomisë, dega “Financë”, në vitin 1985.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vlorë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë, sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vlorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2, të vendimit të KKRR-së nr. 245, datë 2.6.2022 ,“Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vlorë”, bëhet ndryshimi:

“Drejtues Ligjor znj. Raimonda Alliaj.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani